

Erinda Meli

Diplomuar “Juriste” në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 2008. Prej 6 vitesh ka ushtruar profesionin e avokates dhe që nga viti 2009 mban titullin avokat. Në periudhën janar 2014-janar 2018 ka ushtruar detyrën e Këshilltares Ligjore në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Strasbourg, Francë. Në vitin 2021 ka punuar si Këshilltare Ligjore në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Është trajnuar në fusha të ndryshme të së drejtës, si ajo e të drejtave të njeriut dhe të së drejtës ndërkombëtare, si dhe ka vijuar studimet pasuniversitare në të drejtën evropiane. Ka qenë e angazhuar si eksperte ligjore në një sërë projektesh të lidhura me çështjet e të drejtave të njeriut dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Që prej vitit 2018 ushtron detyrën e Avokatit të Shtetit pranë Avokaturës së Shtetit në Zyrën e Këshillimit dhe Koordinimit Ndërministror.